

**V E N D I M**

**Nr.61 Datë 04.06.2008**

**FILLIM I PROCEDURES PER PËRCAKTIMIN E TARIFES SE SHITJES ME  
SHUMICE TE ENERGJISE ELEKTRIKE**


Në mbështetje të neneve 9 dhe 26, pika 1, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.338, date 19.03.2008 „Per miratimin e Modelit te tregut te energjise elektrike“ pika 4.13, germa a, pika 2, dhe neneve 18, pika 1, germa b, dhe 21, te Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, te miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 44, datë 24.07.2007, Bordi Komisionerëve, të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.06.2008, mbasi shqyrtoi kerkesen e KESH sh.a me nr. DEK /IZ 3061 prot, date 26.05.2008 per percaktimin e tarifes se shitjes me shumice te energjise elektrike si dhe propozimin e Drejtorise se Tarifave dhe Çmimeve mbi kete kerkese:

Konstaton se:

- Ligji i Sektorit te Energjise Elektrike percakton ERE-n si autoritetin e vetem per percaktimin e tarifave te shitjes se energjise elektrike.
- Modeli i tregut te energjise elektrike i miratuar me VKM nr.338, date 19.03.2008, parashikon perfshirjen ne tregun e rregulluar te marredhenieve ndermjet Furnizuesit publik me shumice dhe Furnizuesit publik me pakice
- KESH sh.a ka aplikuar ne ERE per percaktimin e tarifave te shitjes me shumice te energjise elektrike per gjashte mujorin e dyte te vitit 2008, me cilesine e shoqerise, njesi e te ciles, ne baze te Modelit te Tregut, pika 2, paragrafi 9, eshte Furnizuesi Publik me shumice.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



- ERE me Vendimet Nr.18; 20 dhe 21, date 14.02.2008 ka percaktuar tarifat e prodhimit, sherbimit te shperndarjes dhe cmimeve te shitjes me pakice te energjise elektrike per konsumatorin tarifore, ne kontekst te te cileve do te percaktohet cmimi i shitjes se energjise elektrike nga Furnizuesi publik me shumice tek Furnizuesi publik me pakice.

Per sa konstatoi me siper, Bordi i Komisionereve

**Vendosi :**

1. Fillimin e procedurave te percaktimit te çmimit te shitjes se energjise elektrike te Furnizesit publik me shumice tek Furnizuesi publik me pakice.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Cmimeve si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, për te njoftur KESH sh. a, mbi vendimin e Bordit te Komisionereve

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**  
**Bujar Nepravishta**